



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPE/SMP	Nr. Prot. 03-3974/12
Dep. 03	Prot. No. 05-11-2012
Nr. llog. 03	Data 05-11-2012
Bros. shprehje	Data
Nr. pages	



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN

Nr.12788/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN me gjykatësin **Nazim Vllaçon** e me procesmbajtësen **Shqipe Simitçiun**, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës **Nurishahe Hulaj** nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga neni 6 parag.1 të ndëshkuar sipas nenit 16 parag.1 p.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik nr.03/L-151, e në bazë të nenit 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datën 25.06.2012

A K T V E N D I M

E pandehura **Nurishahe Hulaj**, nga i ati **Bekë**, e lindur më 1955 në fshatin **Dujak KK Gjakovë** tani me vendbanim në Prizren në rrugën **Brigada 125 L5/3-12**, me kombësi shqiptare, mjeke specialiste, me fakultet të kryer të mjekësisë, e martuar nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme e padënuar për kundërvajtje, Drejtoreshë e Institutit të Shëndetësisë Publike në Prizren.

Ë S H T Ë P E R G J E G J E S E

Sepse si Zyrtare e Lartë Publike-, Drejtoreshë e Institutit të Shëndetësisë Publike në Prizren, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2010 nga parag.1 të nenit 5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik

-me të cilën veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 6 parag.1 të ndëshkuar sipas nenit 16 parag.1 p.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik nr.03/L-151, prandaj me aplikimin e nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet

D Ë N O H E T

Me gjobë në lartësi prej 80 EURO (tetëdhjetë) euro.

E pandehura është e obliguar që gjobën e shqiptuar të paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktvendimit, e në të kundërtën gjoba do të zëvendësohet me dënim burgimi në atë mënyrë që për qdo 15 Euro të gjobës do të caktohet një ditë burg. Obligohet se në afatin e njëjtë të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë paushale prej 5 EURO me kërcënim të përmbarrimit me detyrim. Obligohet e pandehura që pas kryerjes së gjobës dhe të shpenzimeve të lajmërojë Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prizren.

Arsyetim

Me kërkesën e Agjencisë kundër Korrupsionit të Republikës së Kosovës me nr.01-3234/11 të datës 12.07.2011 u zhvillua procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Nurishahe Hulaj nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga neni 16 parag.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik nr.03/L-151.

Gjendja faktike e përshkruar më përseafërmi si në dispozitiv të këtij aktvendimi është vërtetuar në bazë të deklaratës së të pandehurës, përfaqësuesit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, njoftimit të lëshuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publik të Kosovës si dhe me administrimin e provave tjera në shkresat e lëndës.

E pandehura në deklaratën e saj ka theksuar se nuk ka qenë në dijeni lidhur me datën e fundit të deklarimit të pasurisë Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka mohuar të ketë qenë e paisur me formularë për deklarimin e pasurisë dhe se e njëjta ka theksuar se pas marrjes së ftesës nga Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prizren nga vebëfaqja e internetit kishte shkakuar formularët lidhur me Deklarimin e Pasurisë dhe kishte deklaruar Pasurinë Vjetore të cilën fakt ka dëshmuar përmes vërtetimit të lëshuar nga Agjencia kundër Korrupsionit të datës 05.10.2011.

Në cilësi të dëshmitarit është marrë deklarata e përfaqësuesit të Agjencisë kundër Korrupsionit Afrim Atashi. Përfaqësuesi i AKK në deklaratën e vetë ka theksuar se AKK me datën 07.03.2011 ka njoftuar Zyrtarët e Lartë Publik lidhur me deklarimin e pasurisë së tyre ku është cekur se data e fundit të deklarimit të pasurisë është 31.03.2011.

Me qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike gjykatësi me shkresën nr.12788/2011 të datës 19.04.2011 ka kërkuar plotësim nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës lidhur me kundërvajtjen që i vihet në barrë të pandehurës ndërkaq me datën 11.05.2012 nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike është marrë njoftimi se e pandehura Nurishahe Hulaj Zyrtari përmes adresës elektronike të datës 10.03.2011 nga ana e Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike është njoftuar për Deklarimin Vjetor të Pasurisë, Agjencisë kundër Korrupsionit të Republikës së Kosovës

Gjykatësi ka vlerësuar deklaratën e të pandehurës por të njëjtën e ka vlerësuar si shmangie nga përgjegjësia kundërvajtëse ngase me provat tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës pamëdyshje është konstatuar se e pandehura e ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë andaj është shpallur përgjegjëse

Gjatë caktimit të dënimit janë vlerësuar rrethanat nga neni 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet, pesha e kundërvajtjes së kryer dhe pasojat e saja shkalla e përgjegjësisë si dhe rrethanat materiale të pandehurës.

Gjykatësi aplikoi nenin 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet duke ia shqiptuar dënimin nën masën minimale të dënimit për këtë kundërvajtje pasi që e pandehura më parë nuk ka qenë e dënuar për kundërvajtje e njëjta më datën 05.10.2011 ka bërë Deklarimin Vjetor të Pasurisë

03-3974/12/03
sluz

pranë Agjencisë kundër Korrupsionit faktin se për vitin 2012 ka bërë deklarin e pasurisë me kohë, qëndrimi i saj korrekt para gjykatës fakte këto të cilat nuk e përjashtojnë nga përgjegësia kundërvajtëse por që në masë të konsiderueshme e zvogëlojnë përgjegjësinë kundërvajtëse.

Shpenzimet e procedurës janë të caktuar në bazë të nenit 109 al.2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Me sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN

Nr.12788/2012

Dt.25.06.2012

Procesmbajtësja
Shqipe Simitçiu



Gjyqtari
Nazim Vllaço

Nazim Vllaço

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi e në afat prej 8 ditësh nga dorëzimi mund të ushtrohet ankesa Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes të kësaj gjykate pa taksa.